

VENDIM
Nr. 104, datë 23.6.2016

MBI PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË SË VLERAVE REFERUESE NË RAST SE TË DHËNAT E MATJES JANË PËRKOHËSISHT TË PADISPONUESHME DHE TË PAARRITSHME, SI DHE MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË ERE-s NR. 49, DATË 21.10.2004 DHE NR. 146, DATË 24.12.2013

(ndryshuar nga vendimi nr. 181, datë 23.11.2016; nr. 217, datë 27.10.2021; nr. 28, datë 14.2.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16, 76, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015; nenit 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike të ERE-s, në lidhje me miratimin e “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese” në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padis-ponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013”,

konstatoi:

- Me shkresën e OSHEE sh.a. nr. 10473 prot., datë 2.6.2016, është bërë me dije se deri në datën 30 qershor, OSHEE sh.a. do të realizojë pajisjen me matës të të gjithë klientëve.

- Në nenin 76 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” është parashikuar: “Në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.

- Me shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, “Për miratimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me matës jashtë kushtit teknik” dhe nr. 146, datë 24.12.2013, “Mbi kërkesën e “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm për vendosjen e faturimit aforfe përmbushen parashikimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, “Për miratimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me matës jashtë kushtit teknik” dhe nr. 146, datë 24.12.2013, “Mbi kërkesën e “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm për vendosjen e faturimit aforfe” dhe të çdo vendimi që bie në kundërshtim me këtë vendim.

2. a) Në rastet kur furnizuesi merr dijëni nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon akses në të dhënat e matjes), faturimi i energjisë elektrike do të bëhet me vlerë referuese. Kjo vlerë do të përllogaritet bazuar në të njëjtin konsum të muajit respektiv të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj.

b) Për kontratat e furnizimit me energji elektrike, që nuk kanë faturime të muajit referues të vitit të mëparshëm të konsumit me matje të energjisë elektrike, faturimi me vlera referuese të bëhet bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të regjistruar gjatë 12 muajve të fundit, në sistemin e faturimit.

c) Për kontratat e furnizimit me energji elektrike me matës të energjisë elektrike të instaluar në boks kolektiv, përjashtohet faturimi i energjisë elektrike me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes.

ç) Për faturimet me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes, në momentin e leximit të të dhënave të matjes, furnizuesi do të axhustojë në faturën pasardhëse të energjisë elektrike, diferencën ndërmjet sasisë së energjisë së faturuar me vlerë referuese dhe sasisë së energjisë së konsumuar referuar të dhënave të matjes.

d. Konsumatorët që nuk kanë referencë asnjë muaj të leximit të matjes së energjisë elektrike do të faturohen me vlerë referuese 0 kWh.

dh. Konsumatorët që kanë lexim me matje të energjisë elektrike në një periudhë nga 1 (një) deri në 11 (njëmbëdhjetë) muaj, do të faturohen me vlerë referuese bazuar në vlerën mesatare për muajt e matur të konsumit të energjisë elektrike.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 korrik 2016.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti